



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "MAX TV"

Nr. i biznesit 70880954

Pronar – Selami DURMISHI

OK "N.SH. MAX TV"

Rr/ Ilaz Kodra p.n.

Skënderaj

Ref: 1411/1211/LIC/ni

VENDIM

për licencimin e Operatorit Kabllorë, "N.SH. MAX TV"- Skenderaj

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Kandidati për operatorë kabllorë "N.SH. MAX TV" ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë kabllorë, më datën 19 shtator 2014.

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë për operatorë kabllorë “N.SH. MAX TV”, i ka përcjellë përmesë e-maili, përveç rregullores relevante të KPM-së për aplikim për licencë si: Rregullorën e KPM-së për Dhënjën e Licencës KPM-2013/04, Rregullorën për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Taksës së Licencës për Sherbimet Mediale Audio-Vizuale KKPM-2010-02, Rregullorën për operatorët kabllorë CIMC-2007/04, Formën për aplikim për licencë për operatorë kabllorë, edhe listen kontrolluese përmes së cilës listë e ka njoftuar kandidatin mbi dokumentet e nevojshme për aplikim.
7. Komisioni vlerëson se, kandidati “NSH MAX TV” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operatorë kabllorë, në pajtueshmëri me Nenin 7, të Rregullores për Distribuimin Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC 2007/04.
8. Me Rregulloren CIMC 2007/04 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operatorë kabllorë. Prandaj, Komisioni i KPM-së, vlerëson se, një operatorë kabllorë mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve.
9. Kandidati për operatorë kabllorë “NSH MAX TV” do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij programore, vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllorë.
10. Nëse, pas marrjes së licencës, kandidati për operatorë kabllorë “NSH MAX TV” siguron marrëveshje shtesë apo marrëveshje të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllorë, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve të kandidatit. Kandidati “NSH MAX TV” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t’i ketë siguruar ato.
11. Komisioni, vlerëson se “NSH MAX TV” ka paraqitur aplikacionin në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04 si dhe me Rregulloren e KPM-së për Dhënie e Licencës (KPM-2013/04).
12. Komisioni, vlerëson se, kandidati për operatorë kabllorë “NSH MAX TV” ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

13. Komisioni merr vendim që, kandidati “N.SH. MAX TV”, i cili planifikon të operojë në Komunën e Skenderajt, t’i lëshojë licencën e KPM-së për Operatorë Kabllorë, për të ofruar shërbime të programeve përmes rrjetit kabllorë.

14. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllorë “NSH MAX TV”, do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
15. Në pajtueshmëri me Rregulloren KKPM-2010/02 përkatësisht me nenin 5.2 të kësaj rregulloreje, Operatori Kabllorë “NSH MAX TV” duhet ta paguajë taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të vendimit për licencim.
16. Operatori kabllor “NSH MAX TV”, mund të fillojë me ofrimin e listës së programeve për klientët, vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës së KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni i Pavarur për Media, dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



27.11.2014
datë